



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

"METRO MEDIA" Sh.p.k.
Pronar: Sabri Murati
OSHP "METRO TV"
Rr. Sami Frashri nr 53
Prizren

Vendimi LIC/OSHP-KKPM: 2010/19
Ref: 1007/0959/KKPM/mi

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore "METRO TV" - Prizren

Fakte

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore të cilat do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 15 korrik 2010, kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore ka paraqitur në KPM aplikacionin për Licencë të KPM-së.

Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjektet transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së "METRO TV" në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullës CIMC 2007/04 ofruesi i shërbimeve programore "METRO TV" ka paraqitur të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së.
6. Këshilli i KPM-së vlerëson se kandidati "METRO TV" ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit, të cilat mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.


7. Në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore "METRO TV" do të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Këshilli i KPM-së vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "METRO TV" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

9. Këshilli i KPM-së konkludon se "METRO TV" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
10. Këshilli i KPM-së vendosë që, ofruesit të shërbimeve programore "METRO TV", me seli në Prizren, t'i lëshoj licencën e KPM-së për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
11. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca për "METRO TV" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
12. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/04, çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të OSHP është i përcaktuar me Nenin 5.2 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllos (CIMC 2007/05).
13. Në pajtueshmëri me Vendimin e KKPM-2010/10 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit CIMC 2007/05 respektivisht nenin 6.2 të këtij vendim, ofruesi i shërbimeve programore "METRO TV" duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.
14. Ofruesi i Shërbimeve Programore "METRO TV", mund të fillojë transmetimin e programit vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit


15. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.


Filloreta Bytyçi
Kryetare e Këshillit të KPM-së

17/8/2010
datë

Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.


Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive

17.08.2010
datë